

L I G J
Nr.9573, datë 3.7.2006

**PËR AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN, DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE ME
MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE
TË BRAKTISURA DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN ME TO¹**
(ndryshuar me ligjet nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe nr. 106/2018, datë 20.12.2018)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ligji ka si qëllim të rrisë në një shkallë më të lartë sigurinë në qarkullimin rrugor, si dhe të parandalojë e të luftojë trafikun e mjeteve të vjedhura. Gjithashtu, përcakton rregullat që duhen zbatuar për kryerjen e shërbimeve nga subjektet që kryejnë veprimtarinë e autoriparimit, që blejnë, shesin apo ndërmjetësojnë në shitblerje, që pjesëzojnë, rivënë në punë, japin mjete me qira ose vënë në dispozicion të të tretëve mjetet e tyre, që depozitojnë dhe shkatërrojnë mjetet e dala jashtë përdorimit, si dhe përcakton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive, që trajtojnë praktikatat për qarkullimin e mjeteve me motor dhe të rimorkiove.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj disiplinon dhe monitoron veprimtaritë për autoriparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike, blerjen dhe shitjen e tyre, vendruajtjet, dhënien me qira, si dhe mbledhjen, depozitimin dhe shkatërrimin e mjeteve ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura.

Neni 2/1
(shtuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009; hequr shifra “18” me ligjin nr. 106/2018, datë 20.12.2018)

Veprimtaritë e përcaktuara në nenet 3, 12, 14, 16, 20 e 26, të këtij ligji, përfshihen në kategorinë VII.3 të ligjit për licencat. Termi “regjistrim” i përdorur në këto nene, zëvendësohet me fjalën “licencim”. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.

KREU II
DHËNIA E AUTORIZIMEVE PËR VEPRIMTARINË E AUTORIPARIMIT

Neni 3

¹ Ligji nr.9573, datë 3.7.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 28 korrik 2006.
Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr. 106/2018, datë 20.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 15 janar 2019.

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Autoriparim” është riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, të destinuara për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, me përjashtim të shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.

2. “Veprimtari të riparimit” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impianteve e të komponenteve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjetesh me motor.

3. “Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove” është mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karrocërisë, të impiantit elektrik dhe të gomave.

Neni 4

Regjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi

1. Ushtrimi i veprimtarisë së autoriparimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u lejohet vetëm subjekteve, që respektojnë legjisllacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

2. Regjistrimi i subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi bëhet pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, ku subjekti ka selinë, në regjistrin e hapur për këtë qëllim.

3. Regjistri ndahet në 6 seksione:

a) për veprimtaritë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit;

b) për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocërisë;

c) për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik;

ç) për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave;

d) për subjektet që blejnë, shesin mjete me motor dhe rimorkio;

dh) për subjektet që mbledhin, depozitojnë, shkatërrojnë mjetet ose pjesë të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

4. Subjektet, për fillimin e veprimtarisë regjistrohen në regjistër dhe më pas pajisen nga drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor me vërtetimin përkatës, ku përcaktohet edhe lloji i veprimtarisë që do të ushtrohet.

5. Çdo subjekt mund të regjistrohet në një ose më shumë seksione të regjistrit, në përputhje me veprimtaritë që do të ushtrojë.

6. Subjektit nuk i lejohet të kryejë autoriparime të tjera nga ato të përcaktuara në regjistër, për të cilat është pajisur me autorizim.

Neni 5

Mënyra e plotësimit të regjistrit

1. Pajisjet, instrumentet, mjediset e nevojshme, të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit sipas seksioneve, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit.

2. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton me udhëzim modelin e regjistrit, të parashikuar në pikat 2 e 3 të nenit 4 të këtij ligji, si dhe mënyrën e plotësimit të tij.

Neni 6

Kushtet dhe procedurat për regjistrim

1. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton, me udhëzim, kushtet dhe procedurat, që duhet të plotësojnë subjektet për t'u regjistruar.

2. Subjektet, që kërkojnë të regjistrohen në regjistër, duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit.

Neni 7

Veprimtaria e autoriparimit nga subjektet që tregtojnë mjete me motor e rimorkio dhe/ose ushtrajnë veprimtari transporti

1. Veprimtaria e autoriparimit, e realizuar me instrumente ose pajisje ndihmëse, u lejonet edhe subjekteve, që ushtrajnë veprimtari për tregtimin e mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove, si dhe subjekteve që kryejnë transport mallrash për llogari të tretëve.

2. Subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, që të ushtrajnë veprimtarinë e autoriparimit, shënohen në një rën ose në disa nga seksionet e përmendura në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji, sipas veprimtarisë që do të ushtrajnë, pasi të kenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 8

Detyrimet e pronarit ose të përdoruesit të mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove

1. Pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove, për mirëmbajtjen dhe riparimin e këtyre mjeteve, u drejtohen vetëm subjekteve të regjistruara në regjistër, sipas llojit të përcaktuar në autorizimin përkatës.

2. Përjashtohen nga detyrimi i pikës 1 të këtij neni pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove për veprimtaritë e shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.

Neni 9

Përgjegjësi teknik

1. Përgjegjësi teknik, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kërkesa:

a) të mos jetë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji;

b) të ketë aftësi fizike për të kryer këtë veprimtari, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon.

2. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, të cilat përcaktohen në udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e transportit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi me programe të miratuara nga ministria që mbulon fushën e transportit, për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrajnë veprimtari autoriparimi.

Neni 10

Përgjegjësitë e subjekteve që ushtrajnë veprimtari autoriparimi

1. Subjektet e ushtrajnë veprimtarinë e autoriparimit në përputhje me këtë ligj dhe mbajnë përgjegjësi për operacionet e kryera, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (Kontrata e porosisë, kontrata e shitblerjes dhe ajo e qirasë).

2. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton vlerën e garancisë detyruese, që subjektet duhet të ngurtësojnë para marrjes së autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit.

Neni 11

Regjistri i mjeteve në riparim

1. Subjektet, që ushtrajnë veprimtari autoriparimi, të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji, duhet të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korrigjime:

a) targën dhe numrin e shasisë së mjetit, ku do të bëhen ndërhyrjet;

b) të dhënat për ndërhyrjet e realizuara;

- c) datën e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit pronarit të ligjshëm ose personit të autorizuar prej tij;
 - ç) gjenealitetet e personit, që dorëzon mjetin dhe të personit, të cilit i dorëzohet mjeti.
2. Mbatja e të dhënave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet në çastin e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit.

KREU III SHITBLERJA E MJETEVE

Neni 12

Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve të reja ose të përdorura

1. Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, u lejohe vetëm subjekteve juridike, të regjistruara në seksionin përkatës të regjistrit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Blerësi ose personi që zotëron mjete rrugore me motor dhe/ose rimorkio të përdorura, nuk mund t' i përshtasë ato pa kaluar 20 ditë nga data e regjistrimit të blerjes së tyre në regjistër, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13

Regjistri i shitblerjeve

1. Subjekti, që ushtron veprimtarinë e parashikuar në nenin 12 të këtij ligji, duhet të mbajë një regjistër, ku të shënojnë, në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korrigjime:

a) targën e mjetit, nëse e ka, dhe numrin e shasisë që, me çfarëdo titulli, e mban në lokal apo depozitë ose në afërsi të tyre;

b) datën e marrjes në dorëzim të mjetit;

c) treguesit e origjinës së mjetit, nëse ka targë, si dhe të dhënat e dokumenteve të qarkullimit e të datës së regjistrimit;

ç) gjenealitetet e personave, që i sjellin ose i transportojnë mjetet;

d) datën e shitjes ose të heqjes së mjetit, me çfarëdo titulli;

dh) gjenealitetet e blerësit ose të personit, të cilit i është dorëzuar mjeti.

2. Të dhënat për origjinën e mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim të tyre ose në çastin e vendosjes në mjediset që zotërojnë.

3. Të dhënat për shitjen ose heqjen, për çdo arsye, të mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e shitjes ose të heqjes së tyre.

KREU IV NDËRMJETËSIMI NË SHITBLERJE

Neni 14

Veprimtaria e ndërmjetësimit

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, kundrejt pagesës, në shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të reja ose të përdorura, trajtohen si subjekte të tatueshme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

2. Personat, që kryejnë veprime me subjektet e mësipërme, janë të detyruar të identifikohen, nëpërmjet letërnjoftimit ose një dokumenti tjetër, me të njëjtën vlerë, të pajisur me fotografi, të lëshuar nga institucionet shtetërore.

3. Subjektet e lartpërmendura duhet të mbajnë në mjediset ku ushtrojnë veprimtarinë, në vende të dukshme, tabelat e veprimeve që kryejnë, si dhe tarifat përkatëse për çdo ndërhyrje të bërë. Në të kundërt u nënshtrohen sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kryerja e veprimeve të ndryshme nga ato të shënuara në tabelat përkatëse, si dhe marrja e vlerave më të mëdha nga ato të treguara në këto tabela, përbëjnë shkelje dhe dënohen sipas këtij ligji.

Neni 15

Regjistri ditor i veprimtarisë

Subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuar në nenin 14 të këtij ligji, janë të detyruara të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë veprimet që kryejnë çdo ditë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime, gjenealitetet e personave, me të cilët kanë kryer një ndërmjetësim, si dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin.

KREU V

MBLEDHJA, DEPOZITIMI, SHKATËRRIMI I MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, I RIMORKIOVE DHE I PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA

Neni 16

Regjistrimi i subjekteve dhe ushtrimi i veprimtarisë së mbledhjes, depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve

1. Mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të nxjerra jashtë përdorimit, vendosen në vende të veçanta, të përcaktuara në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor, sipas kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.

2. Subjektet lejohen të fillojnë veprimtarinë e mbledhjes, të depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve, pasi të jenë regjistruar pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë, kundrejt autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

3. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin e subjekteve, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon fushën e transportit.

Neni 17

Regjistri i hyrje-daljeve

1. Subjektet, që kryejnë veprimtarinë e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, janë të detyruara të mbajnë një regjistër të veçantë për të gjitha hyrje-daljet, ku të shënojnë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

- a) targën, numrin e shasisë së mjetit dhe gjenealitetet e pronarit ose të personit që e ka dorëzuar apo transportuar;
- b) të dhënat për karakteristikat cilësore dhe sasiore të elementeve që mund të rishfrytëzohen;
- c) treguesit e pjesëve ose të elementeve të rishfrytëzueshme, që janë shitur, me çfarëdo titulli apo janë hedhur, si dhe gjenealitetet e personit, të cilit i janë shitur;
- ç) treguesit sasiore e cilësore të elementeve të papërdorshme, të dërguara për riciklim;
- d) metodën e trajtimit.

2. Regjistri mbahet në mjediset ku kryhen grumbullimi, çmontimi, depozitimi ose copëtimi i mjeteve apo i pjesëve të tyre.

3. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton me udhëzim modelin e regjistrit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe mënyrën e plotësimit dhe të mbajtjes së tij.

KREU VI

SHITBLERJA E PJESËVE TË KËMBIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE TË RIMORKIOVE

Neni 18

Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove

1. Subjektet, përpara se të fillojnë veprimtarinë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve, janë të detyruara të regjistrohen pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë.

2. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin e subjekteve, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon fushën e transportit.

3. Subjektet tregtuese, fabrikuese dhe përfaqësuesit e tyre të huaj, që kërkojnë të tregtojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pjesë këmbimi të mjeteve të importuara nga ata vetë, janë të detyruar të regjistrohen pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë.

4. Regjistrimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar ta bëjnë edhe agjentët, komisionerët udhëtues dhe shitësit ambulante të subjekteve, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Subjektet e sipërpërmendura duhet ta vërtetojnë cilësinë e përfaqësimit nëpërmjet një certificate të lëshuar nga zyra përkatëse e shtetit, ku ka qendrën subjekti dhe të legalizuar nga autoritetet konsullore të atij vendi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Regjistri i shitblerjeve të pjesëve të këmbimit

1. Fabrikuesit, tregtarët, përfaqësuesit e tyre të huaj dhe personat e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji duhet të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë kronologjikisht, krahas datës së marrjes në ngarkim të pjesëve të këmbimit, të elementeve dhe origjinën e tyre, edhe:

- a) datën e shitjes ose të dorëzimit, me çfarëdo titulli, të këtyre pjesëve dhe elementeve;
- b) gjenealogjetet e personave, me të cilët kanë kryer veprime tregtare.

2. Personat, që kryejnë veprime tregtare me këto subjekte, janë të detyruar të vërtetojnë identitetin, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji.

KREU VII

VEPRIMTARIA E AGJENCIVE PËR PRAKTIKAT E QARKULLIMIT TË MJETEVE ME MOTOR DHE/OSE RIMORKIOVE

Neni 20

Ushtrimi i veprimtarisë së trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor

Në kuptim të këtij ligji, me veprimtari të trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove kuptohet kryerja, kundrejt pagesës, e këshillimit, asistencës, përshejtimit të procedurave dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga agjencitë, për llogari të çdo personi ose subjekti që kërkon të kryejë veprimtaritë, që rregullohen me këtë ligj ose që lidhen me qarkullimin rrugor të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove.

Neni 21

Ushtrimi i veprimtarisë së një agjencie

(ndryshuar me ligjin nr. 106/2018, datë 20.12.2018)

1. Veprimtaritë e parashikuara në nenin 20, të këtij ligji, kryhen nga subjektet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Kriteret për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe numri i agjencive, për çdo qytet, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit, duke pasur parasysh numrin e mjeteve me motor të regjistruara.

Neni 22

Njoftimi i agjencie

(ndryshuar me ligjin nr. 106/2018, datë 20.12.2018)

1. Subjektet, titullari i të cilave ka aftësitë profesionale, sipas neneve 23 e 29, të këtij ligji, ushtrojnë veprimtarinë e trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.

2. Subjektet duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt të veprimtarisë së tyre trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.

Neni 23

Vërtetimi i aftësisë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë

1. Vërtetimi i aftësisë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi titullari ka marrë provimin e aftësisë nga komisioni i ngritur me urdhër të ministrit që mbulon fushën e transportit, me punonjës të drejtorive që

mbulojnë këtë veprimtari në ministri dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Sesionet e provimeve janë vjetore dhe kryhen në çdo qark, sipas mënyrave dhe programeve të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të miratuara nga ministri që mbulon fushën e transportit.

3. Provimi bëhet me shkrim, bazuar në pyetësorë me disa përgjigje alternative, për njohjen e legjislacionit të përgjithshëm dhe të veçantë, për qarkullimin rrugor, për transportin e udhëtarëve e të mallrave dhe për sistemin e taksave për këtë sektor. Çështjet, mbi të cilat përgatiten pyetësorët, u vihen në dispozicion të interesuarve të paktën 60 ditë para datës së provimit.

4. Provimit të aftësisë nuk u nënshtrohen personat, që kanë qenë nëpunës të sektorëve të ministrisë që mbulon veprimtarinë, të sektorëve që mbulojnë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të sektorëve që mbulojnë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Rrugore dhe që kanë qenë në këtë detyrë të paktën 3 vjet pa ndërprerje, nga data e hyrjes në fuqi të Kodit Rrugor.

Neni 24

Regjistri ditor i veprimtarisë

Titullari i subjektit (agjencisë) duhet të mbajë një regjistër ditor, ku të shënohen, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

- a) të dhënat identifikuese të klientit kërkues dhe të mjetit të transportit;
- b) data dhe natyra e shërbimit të kërkuar;
- c) veprimet, të cilave u referohet shërbimi i kërkuar.

Neni 25

Tarifat e shërbimit

Tarifat për çdo shërbim përcaktohen nga agjencitë dhe afishohen në tabelat përkatëse, në mjediset ku agjencia kryen veprimtarinë. Në të kundërt, agjencia u nënshtrohet sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VIII

VEPRIMTARIA E VËNIES NË DISPOZICION DHE E DHËNIES ME QIRA TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR PA DREJTUES MJETI

Neni 26

Ruajtja e mjeteve në mjedise private e publike

1. Ruajtja e mjeteve në mjedise private e publike bëhet vetëm me autorizimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë.

2. Në autorizim përshkruhen mjediset, ku do të vendosen mjetet, numri i tyre maksimal, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, daljet e sigurisë dhe çdo element tjetër i nevojshëm për ruajtjen e sigurisë publike.

3. Ministri që mbulon rendin përcakton, me udhëzim, kriteret që duhet të plotësojnë subjektet fizike dhe juridike, për t'u pajisur me autorizim për ruajtjen e mjeteve në mjedise private e publike.

Neni 27

Vënia në dispozicion e mjeteve pa drejtues

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së dhënies me qira të mjeteve pa drejtues, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë lëshon autorizim, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon rendin.

2. Leja jepet nëse subjektet fizike dhe/ose juridike plotësojnë normat në fuqi në fushën e tregtimit, të mbrojtjes nga zjarri dhe të sigurisë.

Neni 28

Regjistri i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të depozituara ose të dhëna me qira

1. Ushtruesit e veprimtarisë, sipas neneve 26 e 27 të këtij ligji, duhet të mbajnë një regjistër, ku të

shënojnë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

- a) datën e marrjes në dorëzim të mjetit dhe datën e ridorëzimit të tij;
 - b) gjenealogjetet e personit, të cilit i dorëzohet mjeti, si dhe të personit që e dorëzon.
2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni shënohen në çastin e marrjes në dorëzim ose të ridorëzimit të mjetit.

KREU IX

DISPOZITAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE MBAJTJA E REGJISTRAVE

Neni 29

Kompetencat për lëshimin e autorizimeve

(ndryshuar pikat 1 dhe 4 me ligjin nr. 106/2018, datë 20.12.2018)

1. Ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuar nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

2. Autorizimet për subjektet juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtarinë e ruajtjes së mjeteve në mjedise private ose publike, të vënies në dispozicion dhe të qiradhënies së mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove pa drejtues mjeti, lëshohen nga drejtoria rajonale e policisë së qarkut.

3. Autorizimet për subjektet juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj, por të ndryshme nga ato të pikave 1 e 2 të këtij neni, lëshohen nga DPSHTRR-ja.

4. Tarifat e dhënies së autorizimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, miratohen nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 30

Kërkesat për marrjen e autorizimeve

1. Autorizimet nuk u jepen personave:

a) të dënuar, me vendim gjykate të formës së prerë, për krime kundër rendit publik dhe/ose kundër personit, të kryera me dhunë, vjedhje, rrëmbim personi, me qëllim përfitimi, dhunë e rezistencë ndaj autoriteteve, ose që kanë kryer dënim me heqje lirie më shumë se tre vjet, për krime për motive të dobëta.

b) që nuk zotërojnë mjedise të përshtatshme pune dhe mundësi të mjaftueshme financiare, të vlerësuara sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit që mbulon fushën e transportit dhe të ministrit që mbulon rendin, të dalë brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Për shoqëritë tregtare, leja lëshohet në emër të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

3. Për shoqëritë, kërkesat e veçanta të formimit ose të aftësisë profesionale duhet të plotësohen, të paktën, nga njëri prej ortakëve.

Neni 31

Përgjegjësia profesionale

Titullari i subjekteve juridike është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është marrë leja, duke mbartur të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 32

Kushtet e autorizimeve

Përveç kushteve të vendosura në këtë ligj, subjekti i pajisur me autorizim duhet të respektojë edhe kushtet e vendosura për interesa publike, nga autoritetet e Policisë së Shtetit.

Neni 33

Vlefshmëria dhe revokimi i autorizimeve

1. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj hyjnë në fuqi një ditë pas lëshimit të tyre dhe kanë vlefshmëri deri në 5 vjet, me të drejtë rinovimi.

2. Autorizimet revokohen kur:
 - a) dëmtojnë interesat e palëve, të cilave u drejtohen;
 - b) të gjitha palët e interesuara bien dakord për revokimin ose shfuqizimin e saj, me kusht që leja të ketë krijuar të drejta të tilla, nga të cilat nuk mund të hiqet dorë.
3. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj mund të revokohen ose të pezullohen në çdo rast nga organi që i ka lëshuar ato, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.
4. Në rast abuzimi nga personi i pajisur me autorizim, autorizim t me delegim mund të revokohen nga organi delegues ose nga organi i deleguar për aq kohë sa delegimi është i vlefshëm.

Neni 34

Përfaqësimi në ushtrimin e veprimtarive të regjistruara

1. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj janë për subjektet e regjistruara dhe nuk mund t'u jepen ose t'u transferohen, me çfarëdo titulli, subjekteve të tjera.
2. Për ushtrimin e veprimtarisë, sipas këtij ligji, është i nevojshëm përfaqësimi. Përfaqësuesi duhet të ketë dokument ligjor përfaqësimi nga subjekti.
3. Gjenealitetet e përfaqësuesit shënohen në titullin e autorizimit.

KREU X

DISPOZITA PËR MBAJTJEN E REGJISTRAVE

Neni 35

Mbajtja e regjistrave

1. Regjistrat e parashikuar në këtë ligj duhet të jenë të numërtuara, të vulosura në çdo faqe nga organet që lëshojnë autorizimet dhe të kompjuterizuara.
2. Këta regjistra duhet të mbahen në gjendje të mirë dhe shënimet duhet të bëhen në mënyrë kronologjike, pa fshirje, korrigjime ose heqje.
3. Me përfundimin e veprimtarisë, për të cilën është lëshuar leja përkatëse, regjistrat i kthehen autoritetit që ka lëshuar autorizimin.
4. Modeli i regjistrave dhe i dokumenteve zëvendësuese, si dhe mënyrat e plotësimit dhe kompjuterizimit të tyre përcaktohen në udhëzimet e përbashkëta të ministrit që mbulon transportin dhe të ministrit që mbulon rendin publik.
5. Regjistrat u vihen në dispozicion autoriteteve të caktuara për kontroll, si dhe autoriteteve të tjera që, për motive të ndryshme, duhet të kontrollojnë shënimet e bëra në regjistra.

Neni 36

Paraqitja e dokumentit të identifikimit

1. Në të gjitha veprimet, për të cilat, sipas këtij ligji, kërkohet identifikimi i personit, është e nevojshme paraqitja e letërnjoftimit ose e një dokumenti tjetër identifikues, me fotografi, të lëshuar nga organet përkatëse shtetërore.
2. Në të gjitha rastet, të dhënat për gjenealitetet e personave, sipas pikës 1 të këtij neni, shënohen në regjistër, së bashku me numrin e letërnjoftimit ose të dokumentit tjetër identifikues.

KREU XI

SANKSIONET DHE USHTRIMI I KONTROLLIT

Neni 37

Mbikëqyrja dhe kontrolli

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për kontrollin dhe zbatimin e këtij ligji, si dhe për vendosjen e mbledhjen e gjobave për kundërvajtjet administrative.

Neni 38

Kontrollet e DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

1. Punonjësit e autorizuar të DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lejohen të hyjnë në mjediset, ku ushtrohen veprimtaritë e parashikuara në autorizimet përkatëse, për të verifikuar përmbushjen e kushteve teknike.

2. Punonjësit e autorizuar të DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit mund të kontrollojnë, në çdo rast, autorizimet dhe regjistrat e subjekteve, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji.

Neni 39

Ushtrimi i veprimtarisë pa autorizim

1. Ushtrimi pa autorizim i çdo veprimtarie, për të cilat ky ligj kërkon marrjen e autorizimit, si dhe shënimi i të dhënave fiktive në regjistrë përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë :

a) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronja “d”, nga 400 000 (katërqind mijë) lekë deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

c) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronja “dh” nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

ç) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 21 pika 1, nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Këto shkelje shoqërohen edhe me konfiskimin e pajisjeve, që kanë shërbyer për të kryer veprimtarinë e jashtëligjshme.

2. Për punime vetëm me karakter operacional ose ndihmës të palicencuar, në funksion të veprimtarisë së autoriparimit, të përcaktuara në seksionet e regjistrat, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, të ndryshme nga ato për të cilat subjekti është regjistruar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

3. Shkelja e dispozitave të nenit 7 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

4. Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë shkeljet e mëposhtme:

a) mungesat ose parregullsitë në plotësimin e regjistrave të parashikuar nga ky ligj, si dhe përdorimi i regjistrave të pavulosur apo me fletë mangët;

b) kryerja e veprimeve me persona të paidentifikuar me letërnjoftim ose dokument tjetër identifikimi.

Neni 40

Shkelja e kushteve të autorizimit

1. Kur titullari i njëres prej autorizimeve të parashikuara në këtë ligj shkel kushtet e përcaktuara në të, kryen kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri 400 000 (katërqind mijë) lekë.

2. Gjoha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe kur titullari i njëres prej autorizimeve të parashikuara në këtë ligj nuk zbaton dispozitat dhe udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji.

Neni 41

Shkelje të tjera

1. Përveçsa është parashikuar në nenet e mësipërme të këtij kreu, shkeljet e dispozitave të tjera të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë.

2. Të ardhurat nga gjobat i kalojnë në masën 40 për qind organit që ka verifikuar shkeljen, për t'i përdorur sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, Ministrit të

Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Brendshëm, për përmirësimin e shërbimit, në zbatim të këtij ligji, kurse 60 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit. Kalimi i të ardhurave në buxhet bëhet sa herë që derdhen para në bankë, duke respektuar raportin e lartpërmendur.

Neni 42

Pushimi dhe pezullimi i veprimtarisë

1. Punonjësit e DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që kryejnë kontrollin, kur vërejnë kundërvajtjet e parashikuara në nenet e mësipërme, kanë detyrimin të paraqesin një raport me shkrim dhe të vënë në dijeni, pa vonesë, autoritetin që ka lëshuar autorizimin.

2. Ky autoritet, me të marrë raportin, nxjerr urdhër, ku shënon edhe arsyet e këtij veprimi, për pezullimin e veprimtarisë së kryer pa autorizimin përkatëse. Urdhri duhet të zbatohet brenda pesë ditëve.

3. Autoriteti, që ka lëshuar autorizimin, kur vëren shmangien e subjektit nga kushtet e përcaktuara në ligj, urdhëron pezullimin e veprimtarisë për atë kohë sa nevojitet për t'i plotësuar këto kushte, por jo më pak se 24 orë dhe jo më shumë se tre muaj. Me skadimin e këtij afati leja revokohet.

4. Urdhri për pezullimin e veprimtarisë revokohet kur i interesuari provon se i ka plotësuar kushtet.

5. Drejtori i policisë në qark, për rrethana të veçanta, urgjente, ose kur rrezikohet siguria e personit, urdhëron menjëherë pezullimin e veprimtarisë së paautorizuar.

Neni 43

Procedura e ankimit dhe afati kohor

1. Organi administrativ përkatës shqyrton ankimin administrativ dhe është i detyruar të marrë vendim brenda një muaji nga data e depozitimit të ankimit.

2. Nëse organi administrativ përkatës nuk ka marrë vendim brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për ankimin e bërë, pala e interesuar fiton të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sipas paragrafit të dytë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në qoftë se organi, që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë autorizimin e ankimuar, vendos t'i pranojë kërkesat e ankimit, ai merr vendimin përkatës.

4. Në qoftë se organi i përmendur në pikën 3 të këtij neni nuk pranon kërkesat e ankimit, ai detyrohet ta transferojë ankimin tek organi epror, i cili vendos brenda 2 javëve.

Neni 44

Dispozita kalimtare

1. Regjistrohen në regjistër subjektet, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, që kanë përvojë prej të paktën 5 vjetësh në këtë fushë dhe që plotësojnë kërkesat e tjera, të parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Subjektet, që përmenden në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit, duhet t'i njoftojnë, me shkrim, ministrisë që mbulon fushën e transportit, emrin e drejtuesit teknik, sipas nenit 8 të këtij ligji.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4989, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu